



**Vodafone Albania ofron mundësi unike karriere për të sapodiplomuarit  
"Discover Vodafone", programi që zbulon talentet**

Vodafone Albania zhvilloi ditën e premte fazën finale të përzgjedhjes së fituesve të programit "Discover Vodafone". Prej disa vitesh, Vodafone Albania sjell mundësi reale për të sapodiplomuarit e talentuar duke mundësuar zhvillimin e skemës globale të zbulimit të talentëve "Discover Vodafone" (Zbulo Vodafone) në Shqipëri. Kjo skemë e veçantë, e zbatuar njëjloj në të gjitha kompanitë e Grupit Vodafone, integron teknikat më të përparuara të identifikimit të talentëve të reja dhe ju hap dyert e një karriere të shkëlqyer në Vodafone.

Edhe këtë vit, interesimi i të rinjve shqiptarë ishte shumë i lartë. Rreth 1000 të rinj aplikuan për të qënë pjesë e kësaj skeme dhe pas disa testimesh të standartizuara, në fazën finale fituan të drejtën të mermin pjesë 24 kandidatë të talentuar, të cilët kaluan në proces testimi tepër dinamik ku gjithsecili pati mundësinë të shfaqë aftësitë dhe kapacitetin nëpërmejt ushtrimeve individuale dhe në grup.

Ndryshe nga vitet e tjera, Vodafone Albania do të përzgjedhë nga faza finale më shumë se 10 fitues, të cilët do të lidhin një kontratë pune me Vodafone Albania për të punuar për 2 vjet në 2-3 sektorë të ndryshëm të kompanisë, për të fituar njohuri të gjera në lidhje me biznesin e telekomunikacioneve dhe kulturën e punës në një kompani lider global si Vodafone.

Kandidatët fitues do të kenë mundësinë e një karriere të suksesshme në kompaninë Vodafone në Shqipëri dhe nëse vijnë të shfaqin një performancë të shkëlqyer, ata do të kenë të hapura dyert për t'u bërë drejtues të Vodafone në nivel global përmes skemës Columbus për zhvillimin e Liderëve të rinj që mundëson rritjen në karrierë në rang global në Vodafone Group.

Programi "Discover Vodafone" është një prej shumë projekteve që Vodafone organizon çdo vit me qëllim zhvillimin dhe mbështetjen e të rinjve për të nisur suksesshëm hapat e para të karrierës së tyre profesionale.